**VENDIM**
**Nr. 692, datë 18.11.2021**

# PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 1128, DATË 30.12.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR ZBATIMIN NGA REPUBLIKA E SHQIPËRISË TË VENDIMEVE TË KËSHILLIT TË BASHKIMIT EVROPIAN, PËR VENDOSJEN, NDRYSHIMIN DHE SHFUQIZIMIN E MASAVE SHTRËNGUESE NDËRKOMBËTARE, TË NDRYSHUARA", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, pika 3, shkronja "c", dhe 6, pikat 2 e 5, të ligjit nr. 72/2019, "Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 5, të kreut I, të vendimit nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, fjalët "... i ndryshuar me vendimin e Këshillit të Bashkimit Evropian (CFSP) 2021/1278..." zëvendësohen me "... i ndryshuar me vendimet e Këshillit të Bashkimit Evropian (CFSP) 2020/607, CFSP 2021/1278 dhe (CFSP) 2021/1800, bashkëlidhur këtij vendimi.".
2. Ngarkohen organet e parashikuara në pikën 1, të nenit 11, të ligjit nr. 72/2019, "Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

VENDIME

VENDIMI I KËSHILLIT (CFSP) 2020/607

i 4 Maj 2020

**amendon Vendimin (CFSP) 2019/1720 lidhur me masat ndaluese nën dritën e situatës në Nikaragua**

KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke patur parasysh Traktatin e Bashkimit Evropian, dhe në veçanti Nenin 29,

Duke patur parasysh propozimin nga Përfaqësuesi i Lartë i Unionit për Marrëdhëniet e Jashtme dhe Politikat e Sigurisë,

Duke u nisur nga fakti që:

(1) Në 14 Tetor 2019, Këshilli vuri në zbatim Vendimin (CFSP) 2019/17/20(') lidhur me masat kufizuese për shkak të situatës në Nikaragua.

(2) Në 14 Tetor 2019, Këshilli gjithashtu mori parasysh një sërë konkluzionesh nëpërmjet të cilave solli në vëmendje shqetësimin e tij për situatën politike dhe sociale degraduese në Nikaragua dhe censurën e rreptë të represionit nga forcat e sigurisë dhe grupet e armatosura pro-qeverisë ndaj kundërshtarëve politikë, protestuesve, mediave të pavarura dhe organizatave të shoqërisë civile që kanë qënë duke ndodhur që nga Prilli i 2018-s. Unioni gjithashtu konfirmoi vendosmërinë e tij për të përdorur të gjitha instrumentet e tij për të mbështetur një zgjidhje paqësore dhe të negociuar të krizës si dhe qëllimet e tij për të monitoruar nga afër situatën në vend me qëllim që të mund të reagojë ndaj degradimit të mëtejshëm të të drejtave të njeriut dhe shtetit të së drejtës.

(3) Këshilli, duke theksuar shqetësimin e tij për situatën e përgjithshme lidhur me të drejtat e njeriut dhe qeverisjes demokratike, vendosi masa kufizuese dhe theksoi se këto masa do të përdoreshin gradualisht dhe me fleksibilitet, dhe që masa më specifike mund të shtohen në rast të një stagnacioni të situatës dhe degradimit të mëtejshëm të të drejtave të njeriut dhe të shtetit të së drejtës.

(4) Për shkak të situatës serioze të vazhdueshme në Nikaragua, 6 persona duhet të përfshihen në listën e personave fizikë dhe juridikë, entiteteve dhe organeve të cilat janë subjekt i masave kufizuese të përcaktuara në Aneksin e Vendimit (CFSP) 2019/1720.

(5) Aneksi i Vendimit (SFSP) 2019/1720 do të amendohet respektivisht,

KA MARRË KËTË VENDIM:

*Neni 1*

Aneksi i Vendimit (CFSP) 2019/1720 është amenduar siç është parashtruar në Aneksin e këtij Vendimi.

Neni 2

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit të tij në *Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.*

Bërë në Bruksel, 4 Maj 2020.

Për Këshillin

Presidenti

G.GRLIC RADMAN

(1) Vendimi i Këshillit (CFSP) 2019/1720 i 14 Tetor 2019 lidhur me masat kufizuese për shkak të situatës në Nikaragua (OJ L 262, 15.10.2019, fq. 58).

*ANEKS*

Regjistrimet e mëposhtme janë vendosur nën titullin "Lista e personave fizikë dhe juridikë, entiteteve dhe organeve referuar në Nenin 1 dhe 2' në Ankesin e Vendimit (CFSP) 2019/1720:

| | Emri | Informacioni Identifikues | Arsyet | Data e listimit |
|---|---|---|---|---|
| 1. | Ramón Antonio AVELLÁN MEDAL | Datëlindja: 11 Nëntor 1954<br>Vendlindja: Jinotepe, Nikaragua<br>Numri i Pasaportës: A0008696<br>Data e lëshimit: 17 Tetor 2011<br>Data e skadimit: 17 Tetor 2021<br>Gjinia: mashkull | Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit të Nikaraguas (NNP) dhe ish shef i policisë në Masaya. Përgjegjës për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut dhe për shtypje të shoqërisë civile dhe opozitës demokratike në Nikaragua, përfshirë dhe koordinimin e shtypjes e protestueve në Masaya në 2018. | 4.5.2020 |
| 2. | Sonia CASTRO GONZÁLEZ | Datëlindja: 29 Shtator 1967<br>Vendlindja: Carazo, Nikaragua<br>Numri i Pasaportës : A00001526<br>Data e Lëshimit: 19 Nëntor 2019<br>Data e Skadimit: 19 Nëntor 2028<br>Numër personal: 0422909670000N<br>Gjinia: femër | Këshilltare e posaçme e Presidentit të Nikaraguas për cështjet e shëndetësisë dhe ish Ministre e Shëndetësisë. Përgjegjëse për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut dhe për shtypjen e shoqërisë civile dhe opozitës demokratike në Nikaragua, përfshirë bllokimin e aksesit për marrjen e ndihmës mjekësore të urgjencës nga civilët e plagosur të përfshirë në demonstrata dhe urdhërimin e stafit të spitalit për të raportuar demonstruesit që ishin sjellë në spital nga policia. | 4.5.2020 |
| 3. | Francisco Javier DÍAZ MADRIZ | Datëlindja: 3 Gusht 1961<br>Gjinia: mashkull | Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit të Nikaraguas (NNP) që nga 23 Gusht 2018 dhe ish Zëvendës Drejtor i NNP. Përgjegjës për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut dhe për shtypje të shoqërisë civile dhe opozitës demokratike në Nikaragua, përfshirë udhëheqjen e forcave të policisë për të ushtruar dhunë ndaj civilëve, përfshirë përdorim të tepruar të forcës, arrestime arbitrare, ndalime dhe tortura. | 4.5.2020 |
| 4. | Néstor MONCADA LAU | Datëlindja: 2 Mars 1954<br>Gjinia: mashkull | Këshilltar personal i Presidentit të Nikaraguas për çështjet e sigurisë kombëtare. Në këtë cilësi ai ka qënë direkt i përfshirë dhe përgjegjës për vendimmarrje për cështje të sigurisë kombëtare dhe bërjen e politikave shtypëse të ndërmarra nga Shteti i Nikaraguas ndaj njerëzve që merrnin pjesë në demonstrata, përfaqësues të opozitës dhe gazetarë në Nikaragua nga Prilli 2018 e në vijim. | 4.5.2020 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 5. | Luís PÉREZ OLIVAS | Datëlindja : 8 Janar 1956<br>Gjinia: mashkull | Komisioner i Përgjithshëm dhe Zyrtari kryesor i Ndihmës Ligjore (DAEJ) në qëndrën penitenciare 'El Chipote'. Përgjegjës për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut përfshirë torturën, përdorimin e tepruar të forcës, keqtrajtim të të ndaluarve dhe forma të tjera degraduese trajtimi. | 4.5.2020 | |
| 6. | Justo PASTOR URBINA | Datëlindja: 29 Janar 1956<br>Gjinia: mashkull | Kreu i Njësisë të Operacioneve Speciale të Policisë (DOEP). Ai ka qënë i përfshirë direkt në zbatimin e politikave shtypëse kundra protestuesve dhe opozitës në Nikaragua, vecanërisht në Managua. Në këtë kontekst, ai është përgjegjës për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut dhe për shtypje të shoqërisë civile dhe opozitës demokratike në Nikaragua. | 4.5.2020 | |

**COUNCIL DECISION (CFSP) 2021/1800**

**of 11 October 2021**

**amending Decision (CFSP) 2019/1720 concerning restrictive measures in view of the situation in Nicaragua**

THE COUNCIL OF THE EUROPEAN UNION,

Having regard to the Treaty on European Union, and in particular Article 29 thereof,

Having regard to the proposal from the High Representative of the Union for Foreign Affairs and Security Policy,

Whereas:

(1) On 14 October 2019, the Council adopted Decision (CFSP) 2019/1720 [1], concerning restrictive measures in view of the situation in Nicaragua.

(2) Decision (CFSP) 2019/1720 applies until 15 October 2021. On the basis of a review of that Decision, the restrictive measures set out therein should be extended until 15 October 2022.

(3) Decision (CFSP) 2019/1720 should therefore be amended accordingly,

HAS ADOPTED THIS DECISION:

*Article 1*

Article 9 of Decision (CFSP) 2019/1720 is replaced by the following:

'*Article 9*

This Decision shall apply until 15 October 2022 and shall be kept under constant review. It shall be renewed, or amended as appropriate, if the Council deems that its objectives have not been met.'.

*Article 2*

This Decision shall enter into force on the day following that of its publication in the *Official Journal of the European Union*.

Done at Luxembourg, 11 October 2021.

*For the Council*
*The President*
J. PODGORŠEK

---

(1) Council Decision (CFSP) 2019/1720 of 14 October 2019 concerning restrictive measures in view of the situation in Nicaragua (OJ L 262, 15.10.2019, p. 58).

**VENDIM I KËSHILLIT (CFSP) 2021/1800**

**i datës 11 Tetor 2021**

**që ndryshon Vendimin (CFSP) 2019/1720 në lidhje me masat kufizuese referuar situatës në Nikaragua**

KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke patur parasysh Traktatin e Bashkimit Evropian dhe, në veçanti, nenin 29 të tij,

Duke patur parasysh propozimin e Përfaqësuesit të Lartë të Unionit për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë,

Meqë:

(1) Më 14 tetor 2019, Këshilli miratoi Vendimin (CFSP) 2019/1720 ([1]) në lidhje me masat kufizuese referuar situatës në Nikaragua.

(2) Vendimi (CFSP) 2019/1720 është i zbatueshëm deri më 15 tetor 2021. Bazuar në një rishikim të atij Vendimi, lipset zgjatja e masave kufizuese të përcaktuara deri më 15 tetor 2022.

(3) Vendimi (CFSP) 2019/1720 duhet kësisoj të ndryshohet përkatësisht,

MIRATON KËTË VENDIM:

*Neni 1*

Neni 9 i Vendimit (CFSP) 2019/1720 zëvendësohet me sa më poshtë vijon:

'*Neni 9*

Ky Vendim do të jetë i zbatueshëm deri më 15 tetor 2022 dhe do jetë ndën rishikim të vazhdueshëm. Ai do të përtërihet, apo ndryshohet sipas rastit, në rast se Këshilli vlerëson se nuk janë përmbushur objektivat e tij.'.

*Neni 2*

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën pas botimit të tij në *Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian*.

Bërë në Luksemburg, më 11 Tetor 2021.

*Për Këshillin*
*Presidenti*
J. PODGORŠEK

[1] Vendimi i Këshillit (CFSP) 2019/1720 i datës 14 Tetor 2019 në lidhje me masat kufizuese referuar situatës në Nikaragua (OJ L 262, 15.10.2019, fq. 58).

# DECISIONS

## COUNCIL DECISION (CFSP) 2020/607

**of 4 May 2020**

**amending Decision (CFSP) 2019/1720 concerning restrictive measures in view of the situation in Nicaragua**

THE COUNCIL OF THE EUROPEAN UNION,

Having regard to the Treaty on European Union, and in particular Article 29 thereof,

Having regard to the proposal from the High Representative of the Union for Foreign Affairs and Security Policy,

Whereas:

(1) On 14 October 2019 the Council adopted Decision (CFSP) 2019/1720 (1) concerning restrictive measures in view of the situation in Nicaragua.

(2) On 14 October 2019 the Council also adopted conclusions in which it recalled its concern at the deteriorating political and social situation in Nicaragua and firm condemnation of the repression by security forces and pro-government armed groups of political opponents, demonstrators, independent media and civil society organisations that had been ongoing since April 2018. The Union also affirmed its determination to use all its instruments to support a peaceful and negotiated solution to the crisis and its intention to monitor the situation in the country closely in order to react to further deterioration of human rights and the rule of law.

(3) The Council, underscoring its concerns with regard to the overall situation in respect of human rights and democratic governance, adopted restrictive measures and noted that those measures would be used in a gradual and flexible manner and that specific designations could be added in the event of a continued stalemate and further deterioration in respect of human rights and the rule of law.

(4) In view of the continuing grave situation in Nicaragua, six persons should be included in the list of natural and legal persons, entities and bodies subject to restrictive measures set out in the Annex to Decision (CFSP) 2019/1720.

(5) The Annex to Decision (CFSP) 2019/1720 should therefore be amended accordingly,

HAS ADOPTED THIS DECISION:

*Article 1*

The Annex to Decision (CFSP) 2019/1720 is amended as set out in the Annex to this Decision.

*Article 2*

This Decision shall enter into force on the date of its publication in the *Official Journal of the European Union*.

Done at Brussels, 4 May 2020.

*For the Council*
*The President*
G. GRLIĆ RADMAN

(1) Council Decision (CFSP) 2019/1720 of 14 October 2019 concerning restrictive measures in view of the situation in Nicaragua (OJ L 262, 15.10.2019, p. 58).

ANNEX

The following entries are inserted under the heading 'List of natural and legal persons, entities and bodies referred to in Articles 1 and 2' in the Annex to Decision (CFSP) 2019/1720:

| | Name | Identifying information | Reasons | Date of listing |
|---|---|---|---|---|
| '1. | Ramón Antonio AVELLÁN MEDAL | Date of birth: 11 November 1954<br>Place of birth: Jinotepe, Nicaragua<br>Passport number: A0008696<br>Issued: 17 October 2011<br>Expires: 17 October 2021<br>Gender: male | Deputy Director-General of the Nicaraguan National Police (NNP) and former chief of the police in Masaya. Responsible for serious human rights violations and for the repression of civil society and democratic opposition in Nicaragua, including by coordinating the repression of protesters in Masaya in 2018. | 4.5.2020 |
| 2. | Sonia CASTRO GONZÁLEZ | Date of birth: 29 September 1967<br>Place of birth: Carazo, Nicaragua<br>Passport number: A00001526<br>Issued: 19 November 2019<br>Expires: 19 November 2028<br>ID number: 0422909670000N<br>Gender: female | Special advisor to the President of Nicaragua on health issues and former Minister of Health. Responsible for serious human rights violations and for the repression of civil society and democratic opposition in Nicaragua, including by hindering access to emergency medical assistance for injured civilians involved in demonstrations and ordering hospital staff to report demonstrators who have been brought to hospital by the police. | 4.5.2020 |
| 3. | Francisco Javier DÍAZ MADRIZ | Date of birth: 3 August 1961<br>Gender: male | General Director of the Nicaraguan National Police (NNP) since 23 August 2018 and former Deputy General Director of NNP. Responsible for serious human rights violations and for the repression of civil society and democratic opposition in Nicaragua, including by leading police forces committing violence against civilians, including excessive use of force, arbitrary arrests and detentions and torture. | 4.5.2020 |
| 4. | Néstor MONCADA LAU | Date of birth: 2 March 1954<br>Gender: male | Personal advisor to the President of Nicaragua on national security matters. In this capacity, he has been directly involved in and responsible for decision-making on national security matters and the establishment of repressive policies carried out by the State of Nicaragua against people taking part in demonstrations, opposition representatives and journalists in Nicaragua from April 2018 onwards. | 4.5.2020 |

| | Name | Identifying information | Reasons | Date of listing |
|---|---|---|---|---|
| 5. | Luís PÉREZ OLIVAS | Date of birth: 8 January 1956<br>Gender: male | General Commissioner and Legal Assistance Main Officer (DAEJ) in the 'El Chipote' penitentiary centre. Responsible for serious human rights violations, including torture, use of extensive force, mistreatment of detainees and other forms of degrading treatment. | 4.5.2020 |
| 6. | Justo PASTOR URBINA | Date of birth: 29 January 1956<br>Gender: male | Head of Police Special Operations Unit (DOEP). He has been directly involved in the implementation of repressive policies against demonstrators and the opposition in Nicaragua, particularly in Managua. In this context, he is responsible for serious human rights violations and for the repression of civil society and democratic opposition in Nicaragua. | 4.5.2020' |